



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

nr.380, datë 02/11/2015

“Për

hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.11.2015, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i informacionit “Mbi procedurën e prokurimit publik të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015” e ndarë në 13 lote.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi procedurën e prokurimit publik të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote.

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 26.10.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 417 prot. na bën me dije se: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote, është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës, 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues, kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë. Nga paraqitja e këtyre ofertave identike, krijohet dyshimi se midis këtyre operatorëve mund të ketë marrëveshje të ndaluar, gjë e cila bie ndesh me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Nga shqyrtimi i mëtejshëm i ofertave të paraqitura nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit të realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt: “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, vërehet se ofertat e paraqitura nga operatorët ofertues për të 13 lotet, janë shumë të njëjta ose shumë afër njëra-tjetrës.

Për sa më sipër, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Ruajtja e objekteve ku është akomoduar administrata tatimore për vitin 2015” mund të ketë kufizime të mundshme të konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1 dhe nenin 42 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;
- II. Periudha e hetimit do të jetë viti 2015.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 18.12.2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Eduard YPI	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Servete GRUDA
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv/Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R